



## Programet e Zyrës së Drejtësisë Civile të qytetit të Nju-Jorkut për ofrimin e aksesit universal të shërbime ligjore për qiramarrësit që përballen me dëbimin nga shtëpia

Në vitin 2017, Këshilli i Qytetit të Nju-Jorkut miratoi ligjin 136, tashmë i kodifikuar si Kreu 13 i Pjesës 26 të Kodit Administrativ të qytetit të Nju-Jorkut, i njohur edhe si ligji historik i qytetit të Nju-Jorkut për aksesin universal në këshillim, i cili i ngarkon Zyrës së Drejtësisë Civile (Office of Civil Justice, OCJ) detyrën që t'u japë akses në shërbime ligjore qiramarrësve që përballen me dëbimin në proceset administrative të gjykatës për strehimin dhe të ndërprerjes së qirasë nga Autoriteti i Strehimit i Qytetit të Nju-Jorkut (New York City Housing Authority, NYCHA). Ligji kërkon që Koordinatori i Drejtësisë Civile të mbajë çdo vit një seancë dëgjimore publike për të marrë rekomandime dhe komente rreth këtyre programeve.

### KUR DHE KU DO TË MBAHET SEANCA DËGJIMORE?

**E mërkurë, 29 janar 2025**

**18:00 deri në 21:00**

**Seanca dëgjimore do të zhvillohet në distancë me Zoom**

### SI MUND TË MARR PJESË?

Çdokush mund të marrë pjesë në seancën dëgjimore nëpërmjet internetit ose me telefon. Mund të jepni komente ose vlerësime në Programin e Aksesit Universal të Shërbimeve Ligjore nëpërmjet:



#### Seancës dëgjimore publike

Ju mund të regjistroheni për të folur në seancën dëgjimore publike duke telefonuar në numrin **929-221-5422** ose duke dërguar email në adresën [civiljustice@hra.nyc.gov](mailto:civiljustice@hra.nyc.gov) më 28 janar 2025 ose para kësaj date. Personat që do të flasin në seancë do të thirren sipas radhës së regjistrimit dhe mund të flasin për jo më shumë se tre minuta.

#### Në internet (video dhe audio):

Vizitoni <https://www.zoomgov.com/j/1617738466>

Ose shkoni në Zoom.us. Klikoni "Join a Meeting". Vendosni **Meeting ID: 161 773 8466**

#### Me telefon (vetëm audio):

Telefononi në numrin **(646) 828-7666**. Kur t'ju kërkohet, vendosni **Meeting ID: 161 773 8466**



**Postës** Mund t'i dërgoni me postë komentet me shkrim në:

Office of Civil Justice / ATTN: HEARING COMMENTS  
NYC DSS Office of Legal Affairs  
150 Greenwich Street, 38th Floor  
New York, NY 10007



**Email-it** Mund t'i dërgoni komentet me shkrim me email në [civiljustice@hra.nyc.gov](mailto:civiljustice@hra.nyc.gov)

Ju lutemi të vendosni "Komente për seancën dëgjimore" te rreshti i subjektit të email-it tuaj.

### AFATI PËR TË DORËZUAR KOMENTET ME SHKRIM ËSHTË DATA 29 JANAR 2025

**NËSE KENI NEVOJË PËR NDIHMË QË TË MERRNI PJESË NË SEANCËN DËGJIMORE**, si për shembull nëse ju nevojitet një interpret ose një akomodim i përshtatshëm për ndonjë aftësi të kufizuar, duhet të na informoni para datës 28 janar 2025. Na telefononi në numrin **929-221-5422**, na dërgoni email në adresën [civiljustice@hra.nyc.gov](mailto:civiljustice@hra.nyc.gov) ose na kontaktoni nëpërmjet postës në adresën e mësipërme.

Publikut do t'i vihet në dispozicion **TRANSKRIPTI I SEANCËS DËGJIMORE** në faqen e internetit të OJC-së [nyc.gov/civiljustice](http://nyc.gov/civiljustice), brenda pak javësh pas seancës dëgjimore.

Për më shumë informacion, vizitoni faqen e internetit të OJC-së [nyc.gov/civiljustice](http://nyc.gov/civiljustice)